

## Vendim nr. 253 datë 29.10.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, në datën 29.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** SHOQËRIA “INTEGRATED ENERGY BV SPV” SH.P.K., përfaqësuar nga avokat Sokol Mëngjesi, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 95, datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 47 (87-2023-225), datë 10.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (urdhër-masë sigurimi reale); nr. 00-2024-8, datë 09.01.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja, shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., është themeluar në datën 31.08.2017, me objekt të veprimtarisë së saj ndërtimin, administrimin, operimin dhe transferimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve në Tiranë dhe prodhimin e energjisë për autoritetin kontraktues etj. Ajo është krijuar si subjekt për qëllime të veçanta (SPV), referuar ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me ortak të vetëm në masën 100% të aksioneve shoqërinë holandeze “GeoGenix B.V” (ish-shoqëria Integrated Energy B.V.). Kjo e fundit është krijuar nga bashkimi i tre shoqërive: “Integrated Technology Services” sh.p.k. me administrator shtetasin K.Z., “Energy Recuperator” s.p.a. dhe “Paul Wurth Italia” s.p.a. Aktualisht shoqëria kërkuese ka administrator shtetasin holandez Herman Daniel Vermeulen. Kërkuesja ka lidhur kontratën e koncesionit nr. 6597 prot., datë 31.08.2017 me Ministrinë e Mjedisit për një projekt me objekt ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi të venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë. Sipas kësaj kontrate, të gjitha veprat dhe çdo ndërtim tjetër në kuadër të projektit do të regjistrohet në emër dhe pronësi të koncesionarit.

2. Mbi bazën e një kallëzimi, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), ka filluar procedimin penal për tre shoqëri tregtare, ndër të cilat edhe kërkuesja si person juridik, për veprat penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 143, paragrafi 3, 25, 260 dhe 287, shkronjat “a” e “b”, paragrafi 2, të Kodit Penal (*KP*).

3. Në kuadër të këtij procedimi, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*), me kërkesë me objekt caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, për personin juridik (shoqërinë kërkuese), së bashku me të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të tij. Sipas prokurorisë, ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë kryer veprat penale për të cilat akuzohet, kërkuesja, e cila si person juridik ka përfituar shuma monetare si rezultat i këtyre veprave dhe se ekziston rreziku se disponimi i lirë i shoqërisë mund të zgjasë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Sipas saj, aksionet disponohen *de facto* nga dy shtetas, K.Z. dhe M. M., të cilët janë nën hetim për të njëjtin fakt penal.

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 95, datë 28.07.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe vendosjen e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive”, ndër të tjera, mbi personin juridik, shoqërinë kërkuese së bashku me të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj. Kjo gjykatë, pasi ka paraqitur të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit nga Prokuroria e Posaçme, ka vlerësuar se ekziston

dyshimi i arsyeshëm se shoqëria, si person juridik, ka shërbyer si mjet për kryerjen e veprave penale për të cilat dyshohen dy shtetasit K.Z. dhe M.M., si rezultat i të cilave kanë përfituar shuma të mëdha monetare. Sipas gjykatës, këta shtetas janë aksionerët *de facto* të shoqërisë kërkuese, të cilët kanë përfituar me fatura tatimore të falsifikuara për punime të kryera si nënkontraktorë të saj. Për rrjedhojë, disponimi i lirë i aksioneve *de facto* të shoqërisë kërkuese nga dy shtetasit nën akuzë mund të sjellë shitjen ose tjetërsimin e aksioneve, duke bërë të pamundur më pas konfiskimin e tyre. Po kështu, disponimi i pasurive të luajtshme e të paluajtshme mund të sjellë shitjen ose tjetërsimin të persona të tretë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*), me urdhrin nr. 47 (87-2023-225), datë 10.10.2023, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 95, datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë në pikën që ka vendosur masën e sigurimit pasuror “sekuestro preventive mbi shoqërinë kërkuese së bashku me të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj. Në ndryshim nga prokuroria dhe gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Posaçme e Apelit ka vlerësuar se veprat penale dyshohet se janë kryer në formën e bashkëpunimit të veçantë në formën e grupit të strukturuar kriminal, sipas parashikimit të neneve 28, paragrafi 4 dhe 334, paragrafi 2, të KP-së. Ndaj këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta dhe heqjen e masës së sigurimit sekuestro preventive.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-8, datë 09.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Kjo gjykatë ka arsyetuar se në rastin konkret po shqyrtohet kërkesa e prokurorit për vendosjen e sekuestros preventive, masë sigurimi reale, bazuar mbi dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, prandaj nuk qëndron pretendimi i kërkueses se ende nuk ka një akuzë të ngritur zyrtarisht. Gjithashtu, sipas saj, gjykatat e faktit kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhjen ndërmjet sendit të sekuestruar dhe aktivitetit kriminal, pasi ka dyshime se shoqëria kërkuese ka shërbyer si mjet për kryerjen e veprave penale, duke përfituar shuma të mëdha monetare.

7. Në datën 30.07.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës. Kolegji i Gjykatës, në datën 08.10.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

8.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë dhe shteruese të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuesja. Konkretisht, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura në lidhje me “pronarin *de facto*”, term i cili nuk parashikohet në legjislacion. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka përcaktuar cili është funksioni dhe detyra ligjore e shtetasve nën hetim në shoqërinë kërkuese dhe nëse njëri prej tyre është caktuar me funksione drejtuese. Gjykata e Lartë ka perifrazuar arsytimin e gjykatave më të ulëta, të cilat kanë paragjykuar çështjen në themel, ndonëse ende nuk ka një akuzë konkrete dhe një kërkesë për dërgimin në gjykim të saj. Për rrjedhojë, është cenuar edhe *e drejta e mbrojtjes*, pasi gjykata nuk ka marrë parasysh asnjë nga provat e paraqitura nga kërkuesja, duke mos i analizuar ato ndonëse ishin pjesë e dosjes gjyqësore, por ka analizuar pretendimet në mënyrë hipotetike.

8.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë analizuar testin e proporcionalitetit midis shkeljes, interesit publik dhe nevojës për të kufizuar të drejtat pasurore të kërkueses. Vendimi për caktimin e masës së sigurimit sekuestro preventive është marrë ndonëse nuk ekziston një akuzë zyrtare, pra nuk është vërtetuar fakti penal. Akuza është ngritur mbi komunikime midis personave, të cilët nuk kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me administrimin e shoqërisë kërkuese dhe nuk kanë pozicione vendimmarrëse. Fakti që ekzistojnë kontrata punësimi ose shërbimesh nuk e arrijnë nivelin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar mbi prova për të kërkuar një masë sigurimi për të gjithë kapitalin dhe asetet e shoqërisë.

8.3. *Parimin e mosdënimit pa ligj (nullum crimen sine lege)*, pasi prokuroria ka krijuar terma juridikë dhe dispozita të reja penale, përkatësisht termin “pronar *de facto*”, me qëllim për të legjitimuar sekuestrimin e kërkueses. Shoqëria kërkuese nuk ka asnjë lidhje me faktet që i atribuohen shtetasve në hetim për sa i përket dhënies së koncesionit të inceneratorit. Gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar gabim nenin 36 të KP-së dhe nenin 274/2 të KPP-së.

### III

## Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

### A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton fillimisht se neni 16, pika 2, i Kushtetutës garanton të drejtat, liritë themelore dhe detyrimet e parashikuara në të edhe për personat juridikë, për aq sa ato përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Në këtë këndvështrim, vlerësohet se kërkuësja, person juridik, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliemeve (*shih vendimet nr. 29 datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, me të cilat është pranuar kërkesa e prokurorisë për vendosjen e masës së sekuestros preventive për kërkuësen si person juridik së bashku me të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj. Nisur nga fakti se Gjykata i ka përfshirë në juridiksionin e saj këto vendime, të cilat ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 29 datë 16.04.2024; nr. 18 datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se

kërkuesja i ka shteruar pretendimet e saj në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë ajo e ka përmbushur edhe këtë kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka vlerësuar se data e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. (shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 09.01.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 30.07.2024. Nga komunikimi me Gjykatën e Lartë, kjo e fundit është përgjigjur se vendimi nr. 00-2024-8, datë 09.01.2024, nuk është publikuar në faqen zyrtare, por nga ana e sekretarisë, në datën 08.04.2024, është kryer publikimi në faqe i informacionit që vendimi mund të tërhiqej pranë sekretarisë së asaj gjykate. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë të fundit si data nga e cila ka filluar afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, si në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe në drejtim të cenimit të së drejtës së pronës dhe parimit të mosdënimit pa ligj. Gjykata në jurisprudencën e saj, për sa u përket vendimeve të caktimit të sekuestros preventive, ka trajtuar pretendimet e kërkuesve në këndvështrim të të drejtave substanciale, kryesisht së drejtës së pronës, ndërsa pretendimet e lidhura me të drejtën për proces të rregullt ligjor, si aspekte procedurale të së drejtës së pronës (shih vendimin nr. 29 datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese). Prandaj, edhe në këtë rast, Mbledhja e Gjyqtarëve do të analizojë pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës së pronës në aspektin procedural dhe substancial të saj.

16. Për sa i përket pretendimit të kërkueses për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ-së, Mbledhja e Gjyqtarëve sjell në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila është shprehur se neni 7 është i zbatueshëm vetëm në rast se masa përbën një “dënim” sipas kuptimit të këtij neni. Për të bërë këtë vlerësim, fillimisht kërkohet që masa në fjalë të vendoset pas dënimit për një "vepër penale". Faktorë të tjerë që merren në konsideratë janë kategorizimi i masës sipas

ligjit kombëtar, natyra dhe qëllimi i saj, procedurat për marrjen dhe zbatimin e saj dhe ashpërsia e kësaj mase (*shih Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 05.02.1995, § 28*). Prandaj, në rastin konkret, për sa kohë sekuestro preventive ndalon që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, vendoset në fazën e hetimit të veprës penale dhe është një masë e përkohshme, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se nuk kemi të bëjmë me një “dënim”, sipas përkufizimit të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj për këto lloj masash nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës substanciale të pronës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuësja ka pretenduar se gjykatat nuk kanë analizuar testin e proporcionalitetit midis shkeljes, interesit publik dhe nevojës për të kufizuar të drejtat pasurore të kërkuësës. Sipas saj, vendimi për caktimin e masës së sekuestros është marrë ndonëse nuk ekziston një akuzë zyrtare, pra nuk është vërtetuar fakti penal, si dhe nuk është arritur niveli i dyshimit të arsyeshëm i bazuar në prova. Për më tepër, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura në lidhje me “pronarin *de facto*”, term që nuk parashikohet në legjislacion dhe nuk ka përcaktuar cili është funksioni dhe detyra ligjore e shtetasve nën hetim në shoqërinë kërkuese dhe nëse njëri prej tyre është caktuar me funksione drejtuese në këtë shoqëri.

18. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e pretendimeve të kërkuësës, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ndonëse ato lidhen me cenimin e së drejtës substanciale të pronës si rrjedhojë e vendimeve të caktimit të masës së sekuestros preventive, kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se cilat janë pasojat e drejtpërdrejta dhe reale në këtë të drejtë kushtetuese dhe në çfarë mënyre është cenuar ajo nga vendimet e vendosjes së masës së sekuestros. Konkretisht, pretendimet e kërkuësës janë me natyrë të përgjithshme, të cilat lidhen me procesin e të provuarit të veprës penale që është nën hetim, duke mos arritur të identifikojë pasurinë konkrete për të cilën është vendosur masa e sekuestros, përveç faktit të ndalimit të shitjes ose tjetërsimit të aksioneve të shoqërisë, fakte edhe këto të prezumuara dhe të paprovuara. Për më tepër, kërkuësja nuk ka arritur të provojë nëse zbatimi i kontratës së lidhur me institucionin shtetëror vijon ose është ndërprerë. Me fjalë të tjera, ajo nuk ka arritur të identifikojë cila prej tagrave të pronësisë është kufizuar nga masa e sigurimit pasuror dhe se si ky kufizim cenon deri në atë masë të drejtën substanciale të pronës, sa nuk mund të riparohet në procesin e themelit. Sikurse rezulton nga rrethanat e çështjes, kërkuësja, si person juridik, është subjekti i cili ka nënshkruar kontratën me institucionin shtetëror, për të cilën janë nën hetim një numër i konsiderueshëm i funksionarëve të lartë shtetërorë, ashtu edhe individë të cilët rezultojnë të kenë marrë pjesë ose të kenë nënshkruar kontrata me shoqërinë kërkuese. Në



këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se objektit të ankimit kushtetues individual të kërkueses i mungon legjitimimi *ratione materiae*, gjë e cila pamundëson tejkalimin e fazës së shqyrtimit paraprak të saj.

19. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash<sup>1</sup>,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

---

<sup>1</sup> Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t’i nënshtrohen gjykimit kushtetues, qëndrim ky i mbajtur dhe i elaboruar në mendimet paralele të vendimit nr. 18, datë 13.03.2024 të Gjykatës.

Gjyqtarët Sonila Bejtja dhe Sandër Beci votuan pro legjitimitit *ratione materiae* të kërkueses, pasi, sipas tyre, pretendimi për të drejtën substanciale të pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, nuk është haptazi i pabazuar. Për këto arsye, në konsideratë të qasjeve të mbajtura nga Gjykata për çështje të tilla, kjo kërkesë duhej të ishte trajtuar në seancë plenare (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).